



| | | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|---------------------|
| Pranuar / Dorezuar Primjeño/Prodato Received/Delivery | 12.05 | 2023 | 3 | viti god year |
| Organ /Njësia Organ /Jedinitca Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity | |
| SKIMSHCK | 4212 | 2023 | 113 | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.651/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtare, me Vjollca Sinani-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.651/2023 të datës 18.04.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi kundër organit të punësimit, Shërbimi Korrektues i Kosovës në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.651/2023 e datës 18.04.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja në pozitën e punës Zyrtare për trajtimin e të burgosurve dhe çështje sociale, me datë 18.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3628/2023 të regjistruar me numër A.nr.651/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 1204 të datës 21.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 26.04.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 05.05.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3628/2023 të regjistruar me numër

A.nr.651/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.04.2023; Vendim për transferim të përkohshëm me nr.1204 të [redacted] e datës 21.01.2022 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në SHKK; E-mail i datës 18.11.2022; E-mail i datës 28.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.04.2023; Përgjigjeje në krekës e organit të punësimit e datës 05.05.2023; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit e datës 06.03.2020 e ankueses; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit e datës 14.02.2020 e [redacted] Përshkrimi i detyrave të punës e ankuese; Ankesën me numër protokolli 1235 e datës 25.11.2022 drejtuar organit të punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesja në bazë ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 06.03.2020, është konstatuar se ankuesja është e emëruar në pozitën e punës Zyrtare për trajtimin e të burgosurve dhe çështje sociale, në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Ankuesja më datë 25.11.2022 ka bërë ankesë tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së me pretendimin ankimor se caktimi i Zyrtares për Punë Sociale në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë [redacted] në pozitën e punës Zyrtare për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve në Drejtoratin për trajtim të burgosurve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës është diskriminues dhe i padrejtë sepse personi i caktuar nuk e plotëson asnjë kriter profesional që i përgjigjet kësaj pozite.

Ndërsa më datë 28.03.2023, ankuesi ka marrë një përgjigje nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore të SHKK-së në lidhje me ankesën e datës 25.11.2022, duke rekomanduar ankuesin që kompetentë në lidhje me ankesat e nëpunësve civil është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ndërsa Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas marrjes së kësaj përgjigjeje nga organi i punësimit, poashtu pretendon se vendimi me nr.1204 i datës 21.11.2022 për transferim të përkohshëm të [redacted] nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në SHKK nuk ka bazë ligjore dhe se nuk ka pasur fare të drejtë të caktohet në këtë pozitë duke kërkuar që Këshilli ta anuloj këtë vendim dhe të aprovohet në tërësi ankesa e saj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...", Kolegji vlerëson se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, përveç që nuk janë respektuar afatet ligjore të adresimit të ankesës në këshill nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses lidhur me marrëdhënien e saj të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesja në ankesën e

parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.651/2023 e datës 18.04.2023, e parashtruar nga ankuesja është e papranueshme.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.651/2023, datë 12/05/2023.

Vjollca Sinani

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuseses
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.